



Planim / Dorezuar Punjen / Predato Recieved / Delivery	23 . 11 . 2020	viti god year	0
Organ / Jështa Org / Unit	Sh. Post Pr. No.	Shifra e Provj Appendix	Sasia Fshikura Quantity
SKPMSTICK	2931/2020		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.289/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyll Bektoshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.289/2020 të datës 08.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi Rr.“Prek Doçi”, Nr.30, në Prishtinë, kundër Vendimit me numër DM 219/2020 të datës 01.09.2020 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike “pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 23.11.2020, mori këtë:

### V E N D I M

I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.289/2020 e datës 08.10.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED], lidhur me ndalimin e 50% të pagës prej datës 01.09.2020, ndërsa refuzohet si e pa bazuar pjesa që ka të bëjë me pretendimin për kthim në vendin e punës.

II. **ANULOHET** Vendimi me numër DM 219/2020 i datës 01.09.2020 i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilin ankuesit i është ndërprerë kompensimi i 50% të pagës mujore.

III. **MBETET** në fuqi Vendimi Nr.7207 i datë 19.09.2014 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për pezullimin parandalues me 50% të pagës, të ankuesit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

IV. **OBLIGOHET** Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke i bërë kompensimin e 50% të pagës së ankuesit nga data 01.09.2020 deri në zbatimin e këtij vendimi, ndërsa të vazhdojë të bëhet pagesa në listën e pagave me 50% të pagës mujore sipas pikës 3 të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

## A r s y e t i m

██████████ Kryesues i Njesisë për Përfaqësime Ligjore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes vendimit Nr.7207 të datë 19.09.2014 të Menaxheres se Personelit është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës mujore, pas njoftimit me numër PPS 36/14 dhe PPKR.nr.44/2014 të datës 18.09.2014 të Gjykatës Themelore në Prizren se ndaj ankuesit ka filluar procedura penale.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka nxjerr Vendimin me numër DM 219/2020 të datës 01.09.2020 përmes të cilit ankuesit ia ka ndërprerë pagesën prej 50% të pagës mujore te cilën ankuesi e realizonte sipas vendimit nr.138 të datës 12.01.2015.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin numër DM 219/2020 të datës 01.09.2020 (të pranuar nga ankuesi me datë 10.09.2020), më datë 08.10.2020 ka parashtruar ankesën me Nr.prot: 2010/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar te Agjencia Kosovare e Privatizimit për përgjigje në ankesë, ndërsa me datë 23.10.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për marrjen e vendimit meritör ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot: 2010/2020 të datës 08.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër DM 219/2020 të datës 01.09.2020 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosvare të Privatizimit; Vendimin me Nr.7207 të datës 19.09.2014 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Dëftesën për pranimin e dërgesës të datës 22.10.2019; Përgjigjen në kërkesën për ndërprerjen e pezullimit të marrëdhënies së punës të datës 03.12.2019 nga Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Përgjigjen në kërkesë për opinion të datës 23.01.2020 të KPMSHCK-së; Vendimin me Nr. 138 të datës 12.01.2015 të U.d. Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Akt Emërimit e datës 01.07.2014 të ankuesit; Kërkesën e datës 24.10.2019 të ankuesit; Ankesën e datës 16.12.209 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Vendimin me Nr. KZKA-2/2020 të datës 20.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Lista e ndryshimit të pagës të datës 01.09.2020; Fletë kthimin e datës 10.09.2020; Parashtresa e datës 12.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kërkesën për pezullim të ekzekutimit të vendimeve nga Institucioni i Avokatit të Popullit të datës 06.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me ndalesën e pagesës prej 50% të pagës mujore, është i bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se me datë 19.09.2014 përmes vendimit Nr.7207 të Menaxheres se Personelit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës mujore, pas njoftimit me numër PPS 36/14 dhe PPKR.nr.44/2014 të datës 18.09.2014 të Gjykatës Themelore në Prizren se ndaj ankuesit ka filluar procedura penale, ndërsa me datë 12.01.2015 me vendimin Nr.138 të Zëvendës Drejtorit Menaxhues

të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ankuesit i është vazhduar pezullimi parandalues nga data 19.09.2014.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me datë 01.09.2020 ka nxjerr vendimin me numër DM 219/2020 përmes të cilit ankuesit ia ka ndërprerë pagesën prej 50% të pagës mujore të cilën ankuesi e realizonte gjatë kohës së pezullimit parandalues, me arsyetimin se Ligji për Zyrtarët Publik, i cili ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020 nuk parasheh kompensim për rastet e pezullimit parandalues.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Vendimi Nr.7207 i datës 19.09.2014 dhe Vendimi Nr.138 i 12.01.2015 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pezullimin e ankuesit nga detyra me 50% të pagës mujore, janë nxjerr bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, përkatësisht nën 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ku përcaktohet së: *1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1.kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/sajë, dhe paragrafi 2, ku përcaktohet se: Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.* Andaj, Kolegji vlerëson se Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër DM 219/2020 të datës 01.09.2020 për ndalimin e 50% të pagës mujore të ankuesit, duke u thirrur në dispozitat e nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gabimisht ka aplikuar dispozitat e ligjit material, në dëm të ankuesit, sepse neni 58 paragrafi 4 aplikohen vetëm për nëpunësit civil të cilët pezullohen nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji, kështu që Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me ndërprerjen e pagesës prej 50% të pagës mujore, është i bazuar, dhe në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ankuesi ka të drejtë të përfitojë 50% të pagës mujore gjatë tërë kohës së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, siç përcaktohet me nenin 69 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se pretendimi i ankuesit për kthim në vendin e tij të punës, është i pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e tij pretendon se me hyrjen në fuqi të Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është anuluar baza ligjore e vendimit Nr.7207 të 19.09.2014 për pezullim parandalues, për faktin se Ligji për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020 nuk parasheh mundësin e pezullimit parandalues të nëpunësit civil për shkak të fillimit të hetimeve, kështu që ankuesi pretendon të anulohet vendimi për pezullim parandalues dhe i njëjti të kthehet në punë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe ka konstatuar se me dispozitat e nenit 56 të këtij ligji janë përcaktuar rastet kur pezullohet nëpunësi civil sipas detyrës zyrtare nga organi përkatës i punëdhënësit, ku sipas paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të kësaj dispozite ligjore përcakton se: *nëpunësi civil pezullohet nga detyra kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi.* Në këtë kontekst Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e nenit 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, dhe ka konstatuar se pezullimi parandalues në kuptim të këtyre dispozitave ligjore nuk është masë disiplinore e cila i shqiptohet nëpunësit civil për shkelje të detyrave të punës,



por është masë parandaluese e cila merret në raport me një procedurë të iniciuar penale ndaj nëpunësit civil dhe ka për qëllim sigurimin e zbatimit të suksesshëm të procedurës penale. Andaj, nisur nga kjo, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konsideron së për rastet pezullimit parandalues të cilat kanë filluar sipas dispozitave të nenit 69 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, nuk mund të aplikohet neni 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, sepse është e ndaluar fuqia prapavepruese e normës juridike, përveç nëse një gjë e tillë përcaktohet me ligj. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka analizuar edhe nenin 83 paragrafi 9 të Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e cila përcakton se; ... *Për procedurat disiplinore në proces, nëse kjo është më e favorshme për nëpunësin civil në fjalë, me kërkesën e tij, zbatohen procedurat e ligjit të ri. E njëjta procedurë do të aplikohet për procedurat e ankesave dhe kontesteve, dhe ka konstatuar se kjo dispozite ligjore i referohet vetëm procedurave disiplinore dhe procedurave të ankesave, por jo edhe masës se pezullimit parandalues e cila nuk është mase disiplinore por është mase parandaluese e cila vendoset vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore në procedurë penale, dhe është e lidhur me zhvillimin e procedurës penale deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, andaj si rrjedhore, Kolegji vlerëson se nëpunësit civil të cilët janë pezulluar sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, mbi këtë bazë ligjore duhet të vazhdoje pezullimi deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, siç përcaktohet me nenin 69 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, kështu që Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me anulimin e vendimit për pezullim parandalues dhe kthimin në vendin e punës, është i pa bazuar.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.289/2020**

**Avdyl BEKTESHI**

*për*  
**Procesmbajtës**

**Jeton KOÇA**

**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit [REDAKTUAR];
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së;